

# NJOFTIM PËR KËSHILLIM PUBLIK

**MBI**

**DHËNIEN NË PËRDORIM TË BREZAVE TË FREKUENCAVE**

**IMT**

**1900-1980 dhe 2110-2170 MHz**

## 1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP,

a) Bazuar në:

- shkronja g) dhe gj) të nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 66 dhe neni 68 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,

b) Me qëllim:

- **përmbyshjen me sukses të politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike,**
- nxitjen e një konkurrence sa më eficiente në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre **si dhe;**
- në plotësim të kërkesave të sipërmarrësve për frekuenca,

nis këshillimin publik për dhënie të drejtash përdorimi në brezat e frekuencave **1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT).**

## 2. Synimi i AKEP është:

Zbatimi i një procesi dhënie të drejtash përdorimi sa me objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatoreve shqiptare dhe ekonomisë shqiptare, krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri, si dhe përdorimin efektiv të spektrit.

## 3. Burimet e spektrit:

Plani Kombëtar i Radio Frekuencave përcakton brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz ku mund të autorizohen shërbimet IMT.

Të drejtat e përdorimit janë parashikuar të jepen në brezin e frekuencave 1970-1980 MHz - çiftuar me 2160-2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915-1920 MHz.

#### **4. Kushtet e përdorimit:**

Në Planin Kombëtar të Frekuencave (dhe brenda CEPT) ky brez është përcaktuar si përdorim kryesor për IMT. Kjo përfshin IMT-2000 dhe IMT – të avancuar. Përdorimi i këtij brezi do të bëhet në përputhje me vendimin e “Electronic Communications Committee”- ECC/DEC/ (06)01 - “The harmonised utilisation of the bands 1920-1980 MHz and 2110-2170 MHz for mobile/fixed communications networks (MFCN) including terrestrial IMT systems”, rekomandimin ERC/REC (01)01 dhe standartin ETSI - EN 301 908.

Bazuar në sasinë e spektrit (2x10 MHz spektër i çiftuar 1970-1980 MHz - çiftuar me 2160-2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915-1920 MHz) AKEP përpara marrjes së vendimeve për vazhdimin e këtij procesi do të vlerësonte opinionin e të interesuarve për përdorimin e këtij spektri lidhur me çështjet e mëposhtme:

- 1. AKEP mendon se numri maksimal i të drejtave të përdorimit është 2 (dy) me nga 5 MHz secila për spektrin e çiftuar (1970-1980 MHz - çiftuar me 2160-2170 MHz) dhe 1 (një) e drejtë përdorimi 5 MHz për spektrin e paçiftuar 1915-1920 MHz.*

*Komentet përkatëse.*

- 2. Bazuar mbi këtë propozim cila është vlera që jeni gati të paguani për të drejtë përdorimi?*

*Komentet përkatëse.*

*Argumentat nëse keni ndonjë çështje tjetër për t’u marrë në konsideratë.*